



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 41 regjistër (JR)
Datë 13.09.2023

Nr. 81 i vendimit
Datë 11.11.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.11.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 41/2023 (JR), datë 13.09.2023, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 666, datë 25.05.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; Kodi i Procedurës Civile; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të depozituara në Kolegji, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 666, datë 25.05.2023, dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ajo iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente, brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³ dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 29.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 29.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklaratat e pasurisë vetting në rubrikën përkatëse.

³ Referuar “Deklaratës për kontrollin e figurës”, dorëzimi është kryer më datë 26.01.2017.

⁴ Referuar “Formularit të vetëvlerësimit profesional”, data e dorëzimit është 27.01.2017.

përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda N. Bushi (Hysa) për vazhdimin e detyrës⁵.

5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016⁶.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale).

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 666, datë 25.05.2023, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

➤ *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, ka kryer deklarime të pamjaftueshme, si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

Nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në momentin e krijimit të pasurive, në shumën totale prej (-) 28.209.341 lekësh, për periudhën 1992 – 2016.

➤ *Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se, nga hetimi administrativ, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës e, për rrjedhojë, konfirmon përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi. [...] Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe*

⁵ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së, nr. {***}, datë 18.11.2022.

⁶ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 10.11.2022.

kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

➤ *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, [...] referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, edhe pse subjektit iu konstatuan problematika në një dosje profesionale dhe një denoncim, por marrë për bazë edhe faktin se nga ana e subjektit janë kryer veprime të caktuara hetimore të shtrira në kohë, subjekti i rivlerësimit vlerësohet se është “e aftë”, duke arritur nivel të besueshëm, kualifikues, në vlerësimin e aftësive profesionale.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 666, datë 25.05.2023, duke e kundërshtuar atë si vendim të padrejtë, të pambështetur në ligj dhe në prova. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi objekt ankimi është marrë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të përcaktuara në nenin 6 të KEDNj-së dhe në nenin 42 të Kushtetutës; në interpretim të gabuar të provave të administruara gjatë hetimit administrativ dhe rezultat i vlerësimit të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjykimin, të vendosë:
 - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
 - *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja ndaj ankueses së rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 666, datë 25.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke vendosur konfirmimin në detyrë të ankueses.*
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
 - 11.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, si pasojë e shkeljes së të drejtës për siguri juridike. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka respektuar jurisprudencën e krijuar prej tij dhe atë të Kolegjit për çështje me rëndësi vendimtare për ankuesen, si dhe ka shkelur parimin e ligjshmërisë për shkak të ekzistencës së gjykimeve të kundërta. Rrjedhimisht, sipas subjektit të rivlerësimit, me këtë vendimmarrje, Komisioni i ka cenuar subjektin edhe të drejtën për respektimin e jetës së saj private, të parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së.
12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, është tërësisht i pabazuar, i pambështetur në provat e administruara, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar.*

12.2. *Vendimi për mosarritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, duke vendosur edhe shkarkimin e saj nga detyra, është pasojë e vlerësimit të gabuar prej Komisionit i të ardhurave të subjektit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit) me burim emigracionin.*

12.3. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar mospërfshirjen nga Komisioni në analizën financiare të kryer prej tij, të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me: (i) reduktimin e shpenzimeve të jetesës deri në janar të vitit 2008, në shumën 8.282.408 lekë; (ii) reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së saj K. H. në shumën 512 euro në vitin 2010, në shumën 720 euro në vitin 2011 dhe 2012; (iii) sistemimin e zërit të të ardhurave nga kursi i këmbimit nga viti 2008 e në vijim.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Miranda Bushi, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

14. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 666, datë 25.05.2023, për rivlerësimin e subjektit, znj. Miranda Bushi, i është njoftuar kësaj të fundit me shkresën nr. {***} prot., datë 21.07.2023, konfirmuar marrja dijani më datë 24.07.2023, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 03.08.2023, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {***}, datë 03.08.2023, që rezultoi të jetë dita e 10 nga data e marrjes dijani për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti e ka dorëzuar ankimin në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 666, datë 25.05.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
16. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit të fashikullit të administruar gjatë këtij procesi në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm, dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

17. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, pretendoi se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, si pasojë e shkeljes së të drejtës për siguri juridike.* Sipas subjektit, Komisioni nuk ka respektuar jurisprudencën e krijuar prej tij dhe atë të Kolegjit për çështje me rëndësi vendimtare për ankuesen, si dhe ka shkelur parimin e ligjshmërisë për shkak të ekzistencës së gjykimeve të kundërta. Rrjedhimisht, me këtë vendimmarrje, Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, i ka cenuar asaj edhe të drejtën për respektimin e jetës private, të parashikuar nga neni 8 i KEDNj-së.
18. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se: (i) bazuar në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të mëparshme, por edhe të vetë Komisionit, ajo kishte pritshmëri se për të ardhurat nga punësimi i ligjshëm në emigracion, do të zbatohet jurisprudenca e konsoliduar në këtë drejtim, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit nuk kanë përgjegjësi disiplinore për mospagimin e detyrimeve tatimore, kur ky detyrim i takon punëdhënësit; (ii) Komisioni nuk ka dhënë arsye për largimin nga jurisprudenca e tij e mëparshme apo mosrespektimin e vendimeve të Kolegjit në lidhje me interpretimin ligjor të së vetmes çështje me ndikim në procesin e rivlerësimit – ligjshmërisë së të ardhurave të fituara nga një punë e ligjshme, në kushtet kur detyrimi tatimor është detyrim i punëdhënësit apo çdo agjenti tjetër tatimor. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka referuar si pjesë të kësaj jurisprudence, vendimmarrjet

për çështjet 14/2021, 6/2022, 4/2023, por pa specifikuar nëse u referohet vendimmarrjeve të Komisionit apo atyre të Kolegjit⁸.

19. Në shqyrtim të këtij shkakut ankimi, pasi shqyrtoi edhe parashtrimet me shkrim të depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për proces të rregullt, adresohen në drejtim të parimit të sigurisë juridike, i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, është cenuar nga ana e Komisionit, si pasojë e vendimmarrjes së këtij të fundit, në kundërshtim me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit në lidhje me vlerësimin e konceptit të të ardhurave të ligjshme me burim emigracionin. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se shqyrtimi i këtij shkakut ankimi duhet bërë në mënyrë të integruar me shqyrtimin e shkaqeve konkrete të ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe burimeve të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, me qëllim konstatimin e drejtë dhe të plotë të situatës faktike për efekt të vlerësimit nga Kolegji në vijim, nëse konkluzionet e arritura nga Komisioni lidhur me këtë çështje përbëjnë apo jo shmangie të pajustificuar nga jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit, në drejtim të vlerësimit të të ardhurave me burim nga emigracioni.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

20. Lidhur me shkakun e ankimit se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, është tërësisht i pabazuar, i pambështetur në provat e administruara, si dhe në parashikimet ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues konstatoi se, në mbështetje të tij, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga interpretimi sistematik dhe logjik që i bëhet Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se asnjë sanksion nuk mund të zbatohet ndaj subjekteve të rivlerësimit nëse organet verifikuese nuk gjejnë dëshmi pozitive se ankuesja ka paraqitur të dhëna të rreme me qëllim fshehjen e pasurisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm, është tërësisht i pabazuar për shkak se ajo ka deklaruar saktësisht pasuritë e zotëruara prej saj dhe burimin e ligjshëm të tyre.
21. Trupi gjykues, në vlerësimin e këtij shkakut ankimi, pasi kontrolloi konkluzionet e arritura nga ana e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, si dhe vlerësoi legjislacionin e zbatueshëm për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, arriti në përfundimin se ky shkak i ankimit dhe pretendimi i subjektit se ajo duhet të konsiderohet se ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, përderisa nuk është arritur në përfundimin për deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë, është i pambështetur në ligj. Ky konkluzion vjen si rrjedhojë e parashikimeve të qarta dhe të shprehura ligjore, sipas të cilave rasti i deklarimit të pamjaftueshëm

⁸Duke qenë se vendimet e Komisionit paraqiten me numra të cilët rriten progresivisht përgjatë gjithë periudhës kohore të veprimtarisë së tij, me shumë probabilitet këto vendime i referohen Kolegjit, sa më sipër edhe në konsideratë të faktit që në tekstin e ankimit gjenden referime në vijim lidhur me vendimmarrje të Kolegjit me të njëjtat të dhëna. Nga verifikimi i arkivit të Kolegjit, rezulton se vendimet nr. (JR) 14/2021, nr. (JR) 6/2022 dhe nr. (JR) 4/2023 u përkasin respektivisht çështjeve të subjekteve të rivlerësimit I. B., H. K. dhe E. O. (Xh.).

për kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezulton nga kontrolli i pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, mbi bazën e një procesi verifikimi të krijimit dhe deklarimit të tyre, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në zbërthim të dispozitës kushtetuese të nenit D të Aneksit të këtij të fundit, ku situatat faktiko-juridike të identifikuar në mënyrë të shprehur nga legjislatori në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, prodhojnë individualisht dhe në mënyrë të pavarur, pasojën e deklarimit të pamjaftueshëm të përcaktuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rast ky për të cilin legjislatori ka përcaktuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Ky qëndrim është tashmë i konsoliduar nga jurisprudenca e Kolegjit, si dhe nga vendimmarrjet e GjEDNj-së⁹ lidhur me çështjet e rivlerësimit të gjykuara nga kjo gjykatë.

22. Lidhur me *shkakun e ankimit për kundërshtimin nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, të vendimit të Komisionit për mosarritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe shkarkimin e saj nga detyra, si rrjedhojë e vlerësimit të gabuar prej Komisionit të të ardhurave të subjektit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortit) me burim emigracionin, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
23. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi ka marrë në analizë të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të përfituara nga emigracioni në Itali për periudhën 1997 – 2004, në kuadër të kontrollit të kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka arritur në konkluzionin se: [...] *për mosdeklarimin e shumës së të ardhurave nga emigracioni për periudhën 1997 – 2004, në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, në kundërshtim me shkronjën “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, ka provuar me dokumentacion ligjor vetëm shumën 1.699 euro, si e ardhur nga emigracioni, shumë kjo e përfshirë që në fillim në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit¹⁰. [...] vendosi të mos marrë në konsideratë/të mos përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga emigracioni në shumën 188.301 euro (nga 190.000 euro vetëm 1.699 euro janë përfshirë në analizën financiare, pasi janë provuar me dokumentacion ligjor), pasi subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti O. H., nuk provuan me dokumentacion ligjor realizimin e këtyre të ardhurave në periudhën 1997 – 2004, si dhe plotësimin e kriterit të ligjshmërisë së tyre, në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016¹¹.*
24. Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, ka kundërshtuar si të pabazuara konkluzionet e mësipërme të Komisionit lidhur me këto të ardhura, duke pretenduar si vijon.

➤ *Në lidhje me mosdeklarimin e shumës së këtyre të ardhurave në deklaratën e pasurisë vetting:*

25. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë të këtyre të ardhurave në deklaratën *vetting*, duke pretenduar se mosdeklarimi i shumës së këtyre

⁹ Shih vendimet lidhur me rastin Xh., S. etj.

¹⁰ Shih arsyetimin e Komisionit në paragrafët 1.8-1.11.9 të vendimit objekt ankimi.

¹¹ Shih paragrafin 13.4 (a) të vendimit të Komisionit.

të ardhurave ka qenë një (lapsus) harresë dhe nuk ka pasur për qëllim shmangien e kontrollit nga institucionet verifikuese mbi ligjshmërinë e tyre, sidomos në kushtet kur këto të ardhura kanë shërbyer për krijimin e pasurive të saj. Sipas subjektit, këto të ardhura në vlerën totale prej 190.000 eurosh, të realizuara në masën 40.000 euro nga subjekti dhe 150.000 euro nga bashkëshorti i saj, janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, si dhe janë deklaruar si burim krijimi i pasurive të tyre rregullisht në deklaratat periodike vjetore, si dhe ka koherencë të plotë midis shumës totale të të ardhurave të realizuara dhe vlerës së përdorur si pjesë e këtyre të ardhurave për krijimin e pasurive në raport edhe me shpenzimet jetike.

26. Subjekti pretendoi se në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka deklaruar burimin e të ardhurave nga emigracioni në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” në të cilën ka dhënë sqarime lidhur me emigracionin në Itali. Këtë deklaram, ajo shprehet se e ka shoqëruar edhe me dokumentacionin justifikues të dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, lidhur me këto të ardhura, si:

(i) leje qëndrimi për të huaj në emër të O. H. për periudhën 11.11.1998 – 6.11.2002, lëshuar nga Ministria e Brendshme Italiane; (ii) kartë identiteti në emër të O. H., lëshuar në datën 21.2.2000, me afat 5-vjeçar; (iii) librezë pune në emër të O. H. ku identifikohen periudhat e punësimit: 17.11.1999 - 5.1.2000; 30.10.2000 - 23.11.2000.; 2.11.2001 - 15.12.2001; (iv) certifikatë e rezidencës në emër të O. H., lëshuar në datën 19.10.2002, në Parma; (v) listëpagesa për aq sa ka mundur të gjejë (*listëpagesa për muajin nëntor 1999 me pagë neto 193 euro, listëpagesa për muajin dhjetor 1999 me pagë neto 455 euro; listëpagesa për muajin janar 2000 me pagë neto 105 euro; listëpagesa për muajin nëntor 2001 me pagë neto 946 euro.*)

➤ *Lidhur me provueshmërinë e shumës së të ardhurave të krijuara në emigracion dhe burimin e ligjshëm të tyre:*

27. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka paraqitur një sërë provash në Komision, nga analiza e të cilave vërtetohet se ajo dhe bashkëshorti i saj kanë krijuar nga burime të ligjshme në emigracion, shumën 190.000 euro. Këtë pretendim, subjekti, sipas ankimit dhe parashtrimeve me shkrim të depozituara në Kolegj, e bazon në:

(i) dokumentacionin e dorëzuar në Komision që provon emigrimin në Itali të subjektit dhe bashkëshortit të saj (bashkëlidhur deklaratës *vetting*);

(ii) të dhënat dokumentare që vërtetojnë punësimin e saj dhe të bashkëshortit të saj në Itali (bashkëlidhur deklaratës *vetting*);

(iii) të dhënat e siguruara nga Intesa SanPaolo Bank që tregojnë trendin e kursimeve në periudhën kur datojnë këto të dhëna (dokumente të dorëzuara në Komision pas kalimit të barrës së provës);

(iv) deklarin e këtyre të ardhurave në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe deklarin e këtyre të ardhurave si burim i pasurive të krijuara në deklarinet periodike vjetore, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë dokumentare;

(v) deklarinet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të zhvilluar në Komision;

(vi) deklaratat noteriale të punëdhënësve të bashkëshortit të subjektit (të cilat konsiderohen prova, bazuar në nenin 49/a dhe 49/b të ligjit nr. 84/2016);

(vii) materializimin e këtyre të ardhurave në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, të deklaruara rregullisht në deklaratën përpara fillimit të detyrës;

(viii) sjelljen korrekte dhe të paqortueshme të ankueses dhe bashkëshortit në tërësi, në kohën kur ka qenë subjekt deklarues.

28. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të padrejtë dhe të palogjikshëm konkluzionin e Komisionit se deklarimi i babait të subjektit mbi depozitimin në bankë të kursimeve të dërguara nga ankuesja dhe bashkëshorti i saj me qëllim përfitimin e interesave bankarë, ka karakter deklarativ dhe se nuk provohet se paratë e depozituara prej tij të jenë të ankueses. Subjekti pretendoi se depozitimet kanë qenë në euro dhe është logjike të mendohet se këto para janë të familjes së ankueses për shkak se babai i ankueses nuk siguronte të ardhura në monedhën euro¹². Në konsideratë, sipas ankueses, duhet të mbahet edhe fakti se veprimi i depozitimit është bërë gjatë kohës që bashkëshorti i subjektit ishte në emigracion, fakt që e bën të besueshëm shpjegimin se këto para gjeneroheshin nga puna e tij në kushtet e mungesës së një burimi tjetër financimi në shtetin italian.
29. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se nga dokumentacioni që ka mundur të sigurojë nga Intesa San Paolo Bank (ish-BIA), rezulton se vetëm në 9 muajt e parë në emigracion, bashkëshorti i saj ka mundur të kursejë një shumë prej 27.750.000 liretash që, bazuar në kursin e këmbimit të kohës, përllogariten rreth 15.000 euro (kursime, jo të ardhura), fakt i cili, sipas saj, vërteton trendin dhe shpeshësinë e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës në emigracion, i cili në vitet në vazhdim ka qenë edhe më i lartë. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe sikur të merret në konsideratë ky trend i muajve të parë në emigracion, rezulton se kursimet e subjektit dhe bashkëshortit të saj nga puna në emigracion përkojnë me shumën e deklaruar të të ardhurave në deklaratën periodike të vitit 2008.
30. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, në kushtet kur: (i) këto të ardhura janë krijuar shumë kohë përpara fillimit të detyrës nga ana e saj; (ii) burimi i tyre nga emigracioni është deklaruar prej saj dhe bashkëshortit të saj që në deklaratën para fillimit të detyrës që e bënte subjekt deklarues para ILDKPKI-së; (iii) të ardhurat janë materializuar në pasuritë e krijuara në periudhën kohore 2001-2008 para marrjes së detyrës së prokurores, çka, sipas saj, dëshmon se nuk bëhet fjalë për deklarim të këtij burimi të ardhurash për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar – standardi i provueshmërisë për këto të ardhura duhet të jetë ai i nxjerrjes së justifikimit bindshëm edhe për një nivel më të ulët të provave sesa do të duhej për të kënaqur standardin e provueshmërisë për pasuritë e vëna gjatë ushtrimit të detyrës apo periudhës së rivlerësimit.

➤ *Në lidhje me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës mbi pagesën e detyrimeve tatimore si element i vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave:*

31. Subjekti i rivlerësimit, pasi referoi se, sipas jurisprudencës së Kolegjit, janë vlerësuar të ligjshme edhe të ardhurat nga paga apo qiratë edhe në rastet kur detyrimet përkatëse tatimore nuk janë përmbushur nga ana e qiramarrësit¹³ apo e punëdhënësit, pretendon se ky standard, sipas së cilit subjekti nuk mund të penalizohet kur mospagesa e detyrimeve tatimore ka qenë pa faj të tij dhe ai

¹² Referimi i subjektit lidhur me depozitimet dhe të ardhurat e të atit në monedhën “euro” duket të jetë një lapsus pasi, referuar akteve, bëhet fjalë për depozitime të kryera në monedhën “lireta”.

¹³ Në rastet e caktuara nga ligji si agjent i mbajtjes së tatimit në burim.

ka qenë në mirëbesim¹⁴, do të duhet të zbatohet edhe në rastin e të ardhurave me burim emigracionin. Sipas subjektit të rivlerësimit, moskonsiderimi si të ligjshme i të ardhurave të krijuara nga emigracioni kur nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore nga punëdhënësit, ndryshe nga sa ndodh me të ardhurat e krijuara nga punësimi apo veprimtari të tjera brenda vendit, cenon parimin e barazisë përpara ligjit duke diskriminuar emigrantët.

32. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa i takon vërtetimit me dokumentacion të plotë provues të shumës prej 190.000 eurosh të të ardhurave të siguruara nga puna në emigracion, pasi disa herë i është drejtuar institucioneve përkatëse italiane apo punëdhënësve të tyre për të verifikuar saktësisht shumën e detyrimeve tatimore të paguara, por nuk ka mundur të marrë përgjigje për shkak të kohës së largët që ka kaluar dhe të faktit se është kthyer nga emigracioni prej më shumë se 20 vitesh.
33. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim dhe në parashtrimet me shkrim para Kolegjit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
34. Fillimisht, trupi gjykues çmon të nevojshme të konstatojë se, si me të drejtë evidentuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, çështja e të ardhurave me burim punën në emigracion të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në Itali, në intervalin kohor 1997-2004, është e vetmja çështje ligjore për të cilën ngrihen pretendime nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, vlerësimi mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave vlerësohet me impakt përcaktues në procesin e verifikimit të ligjshmërisë së krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të dhe analizës së kryer nga Komisioni për këtë qëllim, çmuar kjo në kontekst të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të përdorura prej tyre.
35. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të hetimit të kryer nga Komisioni, si dhe kontrolloi konkluzionet e arritura nga ana e tij lidhur me vlerësimin e këtyre të ardhurave, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë vijon.

➤ *Në lidhje me saktësinë e deklaramit të të ardhurave me burim emigracionin në deklaratën e pasurisë vetting:*

36. Trupi gjykues vëren se në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën që u përket të ardhurave nga “Angazhime dhe veprimtari private [...]” të subjektit të rivlerësimit, nuk ka deklarime mbi të ardhurat e realizuara prej saj nga puna në emigracion. Ndërkohë, në rubrikën e “Të dhënave konfidenciale”, si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, konstatuar edhe nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Sqarim lidhur me emigracionin në Itali. Kemi vajtur në Itali familjarisht (me vizë të rregullt lëshuar nga Ambasada Italiane në Tiranë) në korrik të 1997, për arsye familjare. Atje na kanë pritur disa miq që na kanë sistemuar në shtëpi në “{***}” e më pas në {***}. Bashkëshorti ka punuar vazhdimisht, por pa dokumente sepse punëdhënësit e tij në Itali*

¹⁴ Subjekti ka referuar vendimet e Kolegjit nr. (JR) 14/2021, nr. (JR) 6/2022, nr. (JR) 35/2022 dhe nr. (JR) 4/2023.

nuk e punësonin me dokumente, përveç dy muajve që duheshin për të marrë “permesso di soggiorno”. Më 11.11.1998, bashkëshorti është pajisur për herë të parë me “permesso di soggiorno” në qytetin e Torinos. Ka punuar në shitje kozmetike në disa tregje të Torinos dhe të disa qyteteve të tjera të Italisë. Pagesa nuk ishte fikse, por me përqindje fitimi në bazë të sasisë së produkteve të shitura. Pas kthimit nga puna, ka punuar shpesh edhe në ndërtim. Në tetor të vitit 2001 është spostuar në qytetin e Parmës, ku ka punuar rreth dy muaj në ndërtim për të rinovuar lejen e qëndrimit dhe pastaj është kthyer përsëri në Torino për të vazhduar punën e mëparshme deri në vitin 2004. Unë, në periudhën 1998 – 2003, kam punuar në një paneteri në {***} pranë Piazza {***}, por nuk disponojmë dokumentacion. Të ardhurat e fituara kanë shërbyer për blerjen e aseteve të deklaruara si dhe për përballimin e shpenzimeve familjare ndër vite në Shqipëri.

37. Në rubrikën e të ardhurave nga “Angazhime dhe veprimtari private [...]” që i përket bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit konstatohet të ketë deklaruar: *Të ardhura nga puna në emigracion në Itali, në vitet 1997-2004. Dokumente mbështetëse: fotokopje të pasaportës O. H.; permesso di soggiorno; carta d’identita; libretto di lavoro; bustopaga; certificato di residenza; rapporto di lavoro subordinato (pjesa e dokumenteve që disponoj).* Në rubrikën në të cilën kërkohet të deklarohet shuma e të ardhurave neto të krijuara nga ky aktivitet, bashkëshorti i subjektit nuk ka bërë asnjë shënim.
38. Në analizë të dokumentacionit të dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, si evidentuar më sipër, në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se shuma e të ardhurave me burim emigracionin, e cila provohet me dokumentacion justifikues¹⁵, si me të drejtë konstatuar edhe nga Komisioni, korrespondon vetëm me shumën e 1.699 eurove.
39. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, konstatohet se në deklaratën para fillimit të detyrës si Drejtore e Kabinetit pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të dorëzuar në datën 12.02.2008, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën e të ardhurave të krijuara nga angazhime private dhe publike, ku duhej të deklaronte çdo të ardhur të krijuar nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit (2008), rezultoi të ketë deklaruar të ardhurat me burim emigracionin, të krijuara përpara kësaj date, shprehimisht: *të ardhura nga puna në emigracion në Itali gjatë viteve 1998 – 2003, në shumën 40.000 euro; dhe të ardhura nga puna e bashkëshortit në emigracion gjatë viteve 1997 – 2004, në shumën 150.000 euro.*

¹⁵ i) Leje qëndrimi në emër të shtetasit O. H., për periudhën 11.11.1998 – 6.11.2002, lëshuar nga Ministria e Brendshme Italiane; ii) kartë identiteti në emër të shtetasit O. H., lëshuar në datën 21.2.2000, me afat 5-vjeçar; iii) librezë pune në emër të shtetasit O. H., ku paraqiten periudhat e punësimit: 17.11.1999 – 5.1.2000, 30.10.2000 – 23.11.2000 dhe 2.11.2001 – 15.12.2001; iv) certifikatë e rezidencës në emër të shtetasit O. H., lëshuar në datën 19.10.2002, në Parma, Itali; v) listëpagesë për muajin nëntor 1999, me pagë neto 193 euro pranë punëdhënësit M. G.; vi) listëpagesë për muajin dhjetor 1999, me pagë neto 455 euro pranë punëdhënësit M. G.; vii) listëpagesë për muajin janar 2000, me pagë neto 105 euro pranë punëdhënësit M. G.; viii) listëpagesë për muajin nëntor 2001, me pagë neto 946 euro pranë punëdhënësit {***} di Sh. G.

40. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, e pyetur nga ky i fundit në pyetësin nr. 2¹⁶ lidhur me arsyen e mosdeklarimit të shumës së të ardhurave të krijuara prej saj dhe bashkëshortit nga puna në emigracion, subjekti është përgjigjur: *Mosdeklarimi i të ardhurave nga emigracioni në deklaratën vetting për mua dhe bashkëshortin, është thjesht një lapsus (harresë) dhe e vërteta qëndron ashtu siç është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës 2008: të ardhura nga emigracioni të realizuara nga unë në shumën 40.000 euro dhe nga bashkëshorti 150.000 euro.*
41. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, në lidhje me të ardhurat e krijuara me burim emigracionin, nuk ka qenë i plotë, për sa kohë shuma e të ardhurave neto të pretenduara si të krijuara nga ky burim, nuk rezultoi të jetë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në asnjë prej rubrikave, pavarësisht deklarimit të punës në emigracion si një burim të ardhurash, të cilat rezultojnë të jenë deklaruar edhe si burim për krijimin e një pjese të pasurive të subjektit. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për deklarim të këtyre të ardhurave jo në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a”, vlerësohet të jetë bazuar me të drejtë në konstatimin e mësipërm faktik.
42. Megjithatë, në mungesë të konstatimit gjatë hetimit administrativ të ndonjë qëllimi të shprehur apo edhe të nënkuptuar të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, për të mos i deklaruar këto të ardhura, me synimin e mosbërjes transparencë lidhur me krijimin e tyre, përkundër nga sa rezultoi nga qëndrimi konsistent i saj gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, i vlerësuar ky në harmoni edhe me deklarimin e kryer lidhur me këto të ardhura në deklaratën për herë të parë në vitin 2008, trupi gjykues çmoi të mos i japë peshë paplotësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me këto të ardhura, në drejtim të një konkluzioni sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
43. Trupi gjykues çmon se, për efekt të nevojave të procesit të rivlerësimit, të ardhurat e deklaruara nga subjektet e rivlerësimit merren në analizë sipas vlerave të deklaruara dhe shqyrtohen mbi ligjshmërinë e burimit dhe pagesën e detyrimeve tatimore, në përmbushje të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në raport me masën e deklaruar, e cila deri në provueshmërinë e saj sipas standardeve kushtetuese dhe ligjore, mbetet një vlerë e pretenduar. Në këtë kuptim, nisur nga konsistenca në qëndrime mbi vlerën e pretenduar të të ardhurave me burim emigracionin nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, prej 190.000 eurosh në total, që nga momenti i deklarimit për herë të parë në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2008, trupi gjykues arriti në përfundimin se, pavarësisht mungesës në deklaratën e pasurisë *vetting* të vlerës së të ardhurave me burim emigracionin, masa e këtyre të ardhurave objekt kontrolli mbi vlerësimin e ligjshmërisë, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, është shuma e pretenduar prej 190.000 eurosh.

¹⁶ Shih pyetjen nr. 4 e cila ka këtë përmbajtje: “Në deklaratën vetting, keni deklaruar të ardhura nga emigracioni, por pa përcaktuar vlerë monetare. Në deklaratën para fillimit të detyrës 2008, keni deklaruar të ardhura nga emigracioni të realizuara nga ju në shumën 40.000 euro dhe nga bashkëshorti juaj 150.000 euro. Shpjegoni përse nuk keni përcaktuar vlerë monetare në deklaratën vetting për këto të ardhura?”.

➤ *Në lidhje me provueshmërinë e të ardhurave me burim emigracionin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, dhe masën e pretenduar prej 190.000 eurosh në total:*

44. Së pari, sa u takon të ardhurave me burim emigracionin, trupi gjykues mban parasysh qëndrimin e Kolegjit në vendimmarrje të mëparshme të tij, sipas të cilit jo gjithmonë remitancat mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuadër të nevojave të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht ndërjegjësisimit të trupit gjykues mbi emigracionin si një fenomen historik, social-kulturor dhe problematikave shumëdimensionale të cilat ai mbart me vete në dekada.
45. Në këtë kuptim, në përmbushje të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe kërkesave të pikës 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, të cilat kanë zërthyer për efekt zbatimi nga subjektet e rivlerësimit, dispozitën e sipërcituar kushtetuese, standardi i ndjekur nga Kolegji në vlerësimin e remitancave si burim i ligjshëm të ardhurash, konsiston në detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të provuar dërgimin në vendin e origjinës së vlerave monetare të emigrantëve shqiptarë (qofshin dhe ata vetë), të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit. Për efekt të provueshmërisë së kritereve të sipërcituara, në përputhje me nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin që, në rastet e deklarimit si burim krijimi të pasurive të tyre të ardhurat nga emigracioni, të paraqesin të gjitha dokumentet që provojnë burimin dhe justifikojnë ligjshmërinë e tij, përfshirë dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore përkatëse në vendin e krijimit të të ardhurave. Burimi i të ardhurave duhet të jetë real dhe vlera e të ardhurave të krijuara të jetë konkrete, e matshme dhe e provuar se rrjedh nga punësimi/aktiviteti i ligjshëm i pretenduar nga personi i deklaruar si emigrant¹⁷.
46. Në konsideratë të sa më sipër, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit në lidhje me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ mbi punësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, dhe bashkëshortit të saj gjatë emigrimit të tyre në Itali, në periudhën kohore të viteve 1997-2004, trupi gjykues konstatoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion ligjor, si të ardhura të ligjshme nga emigracioni që përmbushin standardin kushtetues, vetëm shumë prej 1.699 eurosh, është konkluzion i bazuar në fakte dhe në ligj, për sa kohë periudhat e punësimit të provuara sipas librezës së punës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe listëpagesat përkatëse provojnë krijimin e vetëm kësaj shume si të ardhura nga punësimi gjatë periudhës së emigracionit. Fakt ky i pakontestuar edhe nga subjekti i rivlerësimit, duke qenë se në deklaratimet e saj është pranuar punësimi me dokumentacion justifikues, vetëm për periudha të shkurtra disamujore.
47. *Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi vlerën provuese të dokumentacionit të siguruar nga Intesa San Paolo (ish-Banka Italo-Shqiptare), në drejtim të krijimit të të ardhurave*

¹⁷ Shih qëndrimet e Kolegjit në vendimet e tij nr. (JR) 12/2018 dhe nr. (JR) 6/2019 etj.

nga emigracioni dhe kalimin e tyre për mbajtje babait të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

48. Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2023, Intesa SanPaolo Bank ka përcjellë informacion, ndër të tjera, se: *Në vijim të interesimit të klientëve e duke kryer kërkime të thelluara në arkivin kompjuterik të ish-BIA, rezulton se z. N. B. ka pasur marrëdhënie bankare me ish-BIA. Në kërkimin e bërë, rezulton se z. N. B. ka disponuar: (i) llogari bankare në lireta në Bankën Italo-Shqiptare; (ii) depozitë në lireta nr. {***} – nuk rezultojnë detaje të tjera; (iii) depozitë në lireta nr. {***} – nuk rezultojnë detaje të tjera.* Ndër të tjera, banka ka referuar se [...] *ka arritur të rikuperojë dy mandate derdhjeje të z. N. B. [...].*
49. Në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj shkrese, konstatohet një mandat derdhjeje *cash* në shumën 24.750.000 lireta, në datën 03.03.1998, nga z. N. B., në llogarinë e tij të depozitës në lireta me nr. {***}. Në “Formularin e veprimeve në *cash*”, pjesë e dokumentacionit të përcjellë nga banka, konfirmohet derdhja në *cash* nga babai i subjektit të rivlerësimit me profesion mjek, në një depozitë me afat në emër të tij, me qëllim të kryerjes së transaksionit të deklaruar si “veprim tregtar”. Z. N. B. rezulton të ketë nënshkruar gjithashtu edhe një deklaratë sipas së cilës transaksioni në shumën 24.750.000 lireta buron nga një veprimtari e ligjshme dhe nuk ka si qëllim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pasurisë.
50. Sipas mandatit bankar të datës 10.04.1998, z. N. B. ka kryer sërish një depozitim në arkë *cash*, në shumën 3.000.000 lireta, po në të njëjtën depozitë bankare në emër të tij me nr. {***}.
51. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2023, Intesa SanPaolo Bank ka përcjellë informacion edhe në lidhje me të dhënat lidhur me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, z. O. H., sipas të cilave konfirmon se: *në kërkimin e bërë, i ka rezultuar se z. O. H. ka disponuar depozitë në lireta nr. {***} – nuk rezultojnë detaje të tjera.*
52. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e depozituara nga babai i saj në datat 03.03.1998 dhe 10.04.1998, janë të ardhurat e krijuara nga puna e bashkëshortit të saj në emigracion, në Itali, nuk mund të provohet, pasi nuk konstatohet asnjë e dhënë në drejtim të këtij fakti të pretenduar, përveç llojit të monedhës (lireta) që i përket vendit të emigracionit (Itali). Depozitimi nga babai i subjektit i kësaj shume në një depozitë në emër të tij, ndërkohë që në të njëjtën bankë zotëronte depozitë në të njëjtën monedhë edhe bashkëshorti i subjektit z. O. H., e bën të vështirë arritjen në një konkluzion që mbështet pretendimin e subjektit, vetëm në të dhënat e këtyre dy mandateve bankare dhe deklarimeve të babait të subjektit, sipas deklaratës noteriale të datës 15.05.2023, sa kohë, referuar akteve në fashikull, nuk rezulton asnjë e dhënë tjetër që të krijojë një lidhje mes këtyre vlerave monetare dhe bashkëshortëve Bushi-H.
53. Ky version i pretenduar faktesh për kalim të shumave për ruajtje babait të subjektit të rivlerësimit nga bashkëshorti i saj në emigracion, u çmua jobindës nga trupi gjykues edhe në kontekst të

prezencës së saj në Shqipëri në periudhën e kryerjeve të këtyre depozitimeve¹⁸, çka krijoi paqartësi te trupi gjykues se përse këto të ardhura të krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk i janë dërguar subjektit të rivlerësimit për t'u depozituar prej saj në bankë, në llogarinë e bashkëshortit apo të sajën, por babait të saj. Për më tepër, trupi gjykues konstatoi se shuma e këtyre transfertave përfaqëson një përqindje shumë të vogël të vlerës totale të pretenduar, sikundër dhe se kjo mënyrë të operuari (sjellja e likuiditeteve babait të subjektit për mbajtje) nuk rezultoi të përfaqësonte një qasje në vazhdimësi. Këto të dhëna dhe fakti që nuk rezultoi asnjë e dhënë në drejtim të dokumentimit të kalimit të këtyre vlerave monetare (shumës së të ardhurave të pretenduara prej 190.000 eurosh) nëpërmjet transfertave ndërkombëtare bankare, apo qoftë edhe mosdokumentimi në kufi i sjelljes së këtyre vlerave monetare fizikisht, pa paragjykuar mbi burimin e ligjshëm të tyre, u çmuan nga trupi gjykues si elemente me efekt domethënës në analizën mbi provueshmërinë e faktit se të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, janë sjellë në Shqipëri për t'u përdorur si burim krijimi pasurish dhe investimi nga subjekti në vijim.

54. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për qëndrim të gabuar të Komisionit në mospranimin e deklaratës noteriale të dhënë nga babai i subjektit N. B. më datë 15.05.2023, si provë të faktit se likuiditetet objekt i transfertave të kryera prej tij, në datat e sipërcituara, u përkasin të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, me burim nga emigracioni i tij në Itali.
55. Trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion, si më sipër, edhe në lidhje me vlerën provuese të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.09.2022, të z. L. H. (vëllait të bashkëshortit të subjektit) dhe të deklaratës së datës 10.05.2023 të z. G. C. Në arritjen e këtij konkluzioni, në shqyrtim të deklarimeve private të personave të sipërcituar (të pashoqëruara me dokumentacion provues), të cilat u vlerësuan në kontekst të kohës së depozitimit të tyre në Komision¹⁹, si dhe pasi u konstatuan se nuk përputhen²⁰ me të dhënat e tjera të administruara në

¹⁸ Shih shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në paragrafin nr. 46 e vijues të ankimit, deklarinet e saj në procesverbalin "Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive" të mbajtur në ILDKPKI, në datën 14.09.2009, përgjigjet ndaj pyetësorit nr. 2 të Komisionit, si dhe deklarimin e subjektit në rubrikën "Të dhëna konfidenciale" të deklaratës vetting.

¹⁹ Kolegji evidenton, në kontekst të sa më sipër, se deklarata noteriale e z. L. H. me anë të së cilës ky shtetas deklaroi se në vitet 2003 deri në 2008, ka ushtruar aktivitetin privat në fushën e kozmetikës, i regjistruar rregullisht në organet tatimore të shtetit italian dhe se: "nga data e fillimit të këtij biznesi, më datë 11.03.2003, deri në shkurt 2004, kontribut/ndihmë në kryerjen e këtij aktiviteti më ka dhënë vëllai im O. H. [...]. Për këtë periudhë, në këmbim të kësaj ndihme/bashkëpunimi, i kam dhënë nga fitimi i realizuar një shumë si pagë mujore prej 3.000 eurosh" – rezultoi të jetë dorëzuar në Komision gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetjes nr. 3 të pyetësorit nr. 2 të Komisionit lidhur me dorëzimin e dokumentacionit justifikues ligjor për burimin e të ardhurave mbi gjendjen cash në shumën e 100.000 eurove të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008. Ndërkohë që, për shkak të natyrës së posaçme të marrëdhënies mes deklaruesit dhe bashkëshortit të subjektit, ky deklarin nuk duket të ketë pasur ndonjë pengesë për t'u dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës vetting, në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi të ishte deklaruar më parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting fakti i pretenduar se bashkëshorti i saj kishte përfutur këtë sasi të ardhurash në formën e pagës mujore nga i vëllai, z. L. H. Ky dokumentacion nuk rezultoi të jetë dorëzuar as në vitin 2009, në kuadër të kërkesës së ILDKPKI-së gjatë kontrollit të ushtruar mbi deklarimin e kryer nga subjekti dhe bashkëshorti i saj.

²⁰ Trupi gjykues konstatoi se ndërkohë që z. G. C. deklaronte që z. O. H. ka punuar pranë shoqërisë {***} [...] SRL me "detyrën e konsulentit, në periudhat nga data 01.08.1997 - 15.11.1999, me pagesën 2.500.000 lireta neto, tatim

kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit në Komision, u çmuan se janë të pamjaftueshme për të kënaqur kërkesat specifike në përmbushje të standardit kushtetues mbi vlerësimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave nga emigrimi.

56. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme dhe konstatimit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë gjatë hetimit administrativ dhe as gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, burimin e ligjshëm të të ardhurave të pretenduara nga emigracioni në shumën e 190.000 eurove, sipas standardit kushtetues, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se materializimi i të ardhurave të krijuara në emigracion: (i) në pasuri të paluajtshme brenda vitit 2004 (referuar këtu blerjes në vitin 2001 të lokalit në Burrel dhe pagesës së gjithë vlerës që ka burim emigracionin në vitin 2004 për apartamentin në Tiranë); dhe (ii) në gjendjen e likuiditetit *cash* të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008 (shuma prej 52.000 USD, dhënë hua P. Gj. në prill të vitit 2008 dhe kthyer prej tij me transaksion bankar, shuma prej 70.000 eurosh, dhënë hua Sh. K. në dhjetor të vitit 2006 dhe kthyer në fund të vitit 2007, si dhe shuma prej 1.000.000 lekësh, dhënë hua Dh. H. në janar të vitit 2005 dhe kthyer subjektit pak para fillimit të detyrës në vitin 2008) – shërben si tregues i ekzistencës së këtyre të ardhurave, u vlerësuan nga trupi gjykues të pabazuara. Ky konkluzion nuk bazohet vetëm në një analizë dokumentare, por vjen si një rrjedhim logjik nga vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, si pasojë e të cilave nuk u arrit të krijohet një lidhje logjiko-faktike mes shumës së të ardhurave të pretenduara, realizimit të tyre nga burime të ligjshme gjatë periudhës së emigracionit dhe dërgimit e përdorimit të tyre në Shqipëri, për investime në pasuri të paluajtshme e likuiditete. Në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues mbajti në konsideratë, përpos të tjerave, edhe faktin e mosdeklarimit të burimit të gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2008, në shumën e 100.000 eurove, dhe saktësimin e burimit të këtyre të ardhurave vetëm në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit në vitin 2022.
57. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se fakti që këto të ardhura dhe pasuri janë krijuar para miratimit të paketës kushtetuese të reformës në drejtësi, e cila miratoi rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet për efekt të kontrollit të pasurive të tyre dhe kohë përpara fillimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duhet të ishte mbajtur në konsideratë nga Komisioni në drejtim të provueshmërisë së këtyre të ardhurave

*në burim; nga data 15.01.2000 – 30.10.2000, me pagesën 2.700.000 lireta neto, tatim në burim”, duke nënkuptuar që ky ka qenë një punësim i rregullt i bashkëshortit të subjektit të cilit i është mbajtur në burim edhe tatimi përkatës që nga dita e parë e mbërritjes në shtetin italian, nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrative, por edhe nga sa deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj është pajisur me dokumentin përkatës për qëndrim të ligjshëm në Itali (permesso di soggiorno per stranieri {***}) vetëm në datën 11.11.1998. Gjithashtu, rezultoi se në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive” në datën 14.09.2009, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj dhe Inspektori i Lartë i ILDKPI-së F. K., bashkëshorti i subjektit i pyetur për të dhënë sqarime dhe dokumentacion mbi të ardhurat e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës së subjektit në datën 12.02.2008, ka deklaruar: “Së bashku me familjen kam qenë emigrant në Torino dhe në Parma nga korriku i vitit 1997 deri në fund të vitit 2003. Kam kryer punë të ndryshme dhe, ndër to, në tregti kozmetike me një sipërmarrës italian, por i paregjistruar në institucionet përkatëse, dhe në ndërtim gjithashtu kam të regjistruar vetëm tre muaj në firmën “{***}” në Parma. Nga puna prej 6 vitesh në emigracion, kam përfituar përafërsisht 150.000 euro, por ashtu siç e theksova dhe më sipër, nuk disponoj dokumentacion”.*

sipas një standardi provueshmërie, bazuar në justifikimin bindshëm për një nivel më të ulët të provave sesa krahasuar me standardin e provueshmërisë për pasuritë e krijuara gjatë detyrës, u çmua nga trupi gjykues pa relevancë në shqyrtimin e rastit konkret. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë specifikat e kësaj çështjeje se: (i) subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, e cila është gjendur para detyrimit kushtetues për t'u rivlerësuar sipas parashikimeve kushtetuese, ka ushtruar detyrën e saj si prokurore në vitet 1992 – tetor 1998 dhe 2012 – e në vazhdim, ndërkohë që në periudhën e ndërmjetme ka qenë në emigracion në Itali për një periudhë gati 5-vjeçare dhe, në vazhdim, ka ushtruar detyra të larta në institucionet e drejtësisë²¹; (ii) të ardhurat e pretenduara e deklaruar nga puna e saj dhe e bashkëshortit në emigracion, paraqiten në vlerë të konsiderueshme dhe me peshë përcaktuese në analizën e burimeve të pasurive të deklaruar, ndërkohë që vlera e të ardhurave të provuara e të vlerësuar si të ardhura të ligjshme, në kuptim të standardit kushtetues të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, rezultojnë të jetë modeste (në shumë të papërfillshme, referuar vlerës totale të pasurive të deklaruar). Aplikimi i një standardi të ndryshëm, më të ulët provueshmërie të këtyre të ardhurave, në vlerësim të trupit gjykues, do të rezultonte në një proces kontrolli formal të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit D të Aneksit të tij.

➤ *Në lidhje me çështjen e vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga emigracioni, në kuptim të standardit kushtetues të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencës së krijuar nga Kolegji në këtë drejtim:*

58. Pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, në konsideratë të fakteve të konstatuara mbi periudhën e dokumentuar të punësimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, dhe pamundësinë për të provuar punësimin e ligjshëm të saj dhe bashkëshortit përtej periudhës së konstatuar nga Komisioni sipas dokumentacionit të dorëzuar nga vetë subjekti, si dhe masën e të ardhurave të krijuara në shumën e pretenduar, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i arritur nga Komisioni për moskonsiderimin si të ardhura të ligjshme të shumës prej 188.301 eurosh (si diferencë e shumës së pretenduar prej 190.000 eurosh dhe shumës së provuar me dokumentacion ligjor prej 1.699 eurosh), është një konkluzion i mbështetur në fakte dhe në ligj dhe në përputhje me standardin e zbatuar nga Kolegji lidhur me çështje të ngjashme²², si trajtuar gjerësisht më sipër në këtë vendim.
59. Bazuar në sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi shkelje të rënda procedurale në kuptim të cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas parashikimeve të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, referuar cenimit të parimit të sigurisë juridike, si pasojë e një vendimmarrjeje të Komisionit që vjen në kundërshtim me standardet e vendosura nga Kolegji në jurisprudencën e tij të deritanishme lidhur me çështjen e vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave nga emigracioni, vlerësohen nga trupi gjykues të pabazuara.

²¹ Në periudhën tetor 1998 – dhjetor 2003, ka qenë në emigracion në Itali; gjatë periudhës shkurt 2004 – janar 2008, ka ushtruar detyrën e Kancelares pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, Tiranë; dhe nga janari 2008 – qershor 2012, detyrën e Drejtores së Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm.

²² Shih vendimet e Kolegjit nr. (JR) 12/2018 dhe nr. (JR) 6/2019 etj.

60. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të kryerjes së një analize të ndryshme mbi nevojën dhe standardin e kërkuar të provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore të të ardhurave nga punësimi në emigracion, krahasuar me vlerësimin e së njëjtës çështjeje për burime të ardhurash brenda vendit, vlerësohen nga trupi gjykues pa efekt në zgjidhjen e çështjes konkrete, për sa kohë në rastin objekt shqyrtimi, bëhet fjalë për pamundësi të subjektit të rivlerësimit për të provuar periudhën e pretenduar të punësimit dhe masën reale të të ardhurave të krijuara, më shumë se sa të provuarin e pagesës së detyrimeve tatimore. Në këtë kuptim, analiza juridike në lidhje me nevojën apo jo të zbatimit të një standardi më të ulët provueshmërie të së ardhurës së ligjshme, në drejtim të pagesës së detyrimeve përkatëse tatimore, vlerësohet nga trupi gjykues pa efekt në rastin konkret.
61. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim se ajo ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga emigracioni, duke referuar pamundësinë për të marrë një përgjigje nga autoritetet italiane dhe punëdhënësit e saj dhe të bashkëshortit të saj dhe, për këtë arsye, Komisioni duhet të kishte vlerësuar se ajo ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas parashikimeve të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se, referuar parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se punësimi i saj dhe i bashkëshortit të saj, përveç periudhave të dokumentuara sipas akteve të dorëzuara bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, ka qenë në kushte informaliteti, përpjekjet për kualifikimin e pamundësisë së saj për të dorëzuar dokumentacion justifikues, në kuadër të detyrimit ligjor për justifikimin e saktësisë dhe ligjshmërisë së deklarimeve, si pamundësi objektive në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohen të pabazuara.
62. Në këtë kuptim, trupi gjykues gjeti të drejtë dhe të bazuar në fakte e në ligj konkluzionin e arritur nga Komisioni se *pretendimi i subjektit që ndodhet në kushtet e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk qëndron, për faktin se kërkesat e nenit 32 janë të lidhura me pamundësinë objektive të subjektit të rivlerësimit për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të këtyre të ardhurave në rastin konkret, ndërkohë që subjekti ka deklaruar qartë se nuk disponon dokumentacion justifikues për këto të ardhura, pasi të dy ata (subjekti me bashkëshortin) kanë punuar të paregjistruar në organet tatimore, për më tepër që vetë subjekti ka paraqitur dokumentacion zyrtar mbi të ardhurat për vitet 1999, 2000 dhe 2001.*
63. Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni, se të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në shumën totale prej 190.000 eurosh, me burim emigracionin në Itali, përkatësisht 40.000 euro të realizuara nga subjekti i rivlerësimit në periudhën e viteve 1998-2003 dhe 150.000 euro nga bashkëshorti i saj në periudhën e viteve 1997-2004, të cilat kanë shërbyer si një ndër burimet e krijimit të pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk u arrit të shpjegohen bindshëm dhe të provohen nga provat e administruara, sipas standardit të kërkuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitat

zbatuese të ligjit nr. 84/2016, as gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, as gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj.

64. Bazuar në konkluzionin e mësipërm, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me pasuritë objekt kontrolli, për të cilat të ardhurat nga emigracioni kanë shërbyer si një ndër burimet e krijimit, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion si Komisioni, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk arritën të përmbushin detyrimin kushtetues të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, duke rezultuar edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, në kushtet e mungesës së njëjtë të burimeve financiare të ligjshme²³, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për krijimin e pasurive objekt kontrolli si më poshtë:
- Pasurisë së paluajtshme të llojit “lokal” me sipërfaqe ndërtimi 390 m² dhe sipërfaqe totale trualli 1214 m², me vendndodhje në Burrel, blerë në vitin 2001, në shumën 7.300.000 lekë.
 - Pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 118 m², me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, objekt i kontratës së sipërmarrjes të lidhur në vitin 2004, në shumën 62.540 euro.
 - Pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me sipërfaqe 68,6 m², me vendndodhje në {***}, Vlorë, blerë në vitin 2009 në shumën 35.000 euro.
 - Pasurisë së luajtshme të llojit automjet të tipit “Golf 4”, e blerë në vitin 2008, në shumën 8.000 euro.
 - Pasurisë së llojit likuiditet në formë depozite në Credins Bank, në shumën 5.076.501 lekë.
65. Në lidhje me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për rezultatin e analizës financiare edhe si pasojë e mospërfshirjes nga Komisioni në këtë analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me: (i) reduktimin e shpenzimeve të jetesës deri në janar të vitit 2008, në shumën 8.282.408 lekë; (ii) reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së saj K. H. në shumën 512 euro në vitin 2010, në shumën 720 euro në vitet 2011 dhe 2012; (iii) sistemimin e zërit të të ardhurave nga kursi i këmbimit nga viti 2008 e në vijim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.
66. Subjekti pretendoi se konkluzioni i Komisionit në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në Itali, për periudhën 1998-2004, në shumën 8.788.345 lekë, është i gabuar, pasi këto shpenzime kanë qenë më të ulëta, pasi në vitet e para të jetesës në Itali janë ndihmuar nga vëllai i bashkëshortit lidhur me shpenzimet e qirasë. Subjekti i rivlerësimit i pretendoi shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në shumën 8.282.408 lekë. Sipas saj, edhe nëse këto shpenzime do të përlllogariten sa Komisioni, analiza financiare e kryer për verifikimin e pasurive përpara fillimit të detyrës, do të rezultonte pozitive. Subjekti pretendoi reduktimin e shpenzimeve të jetesës edhe për faktin se shpenzimet e jetesës për vajzën e mitur K. H. në vitin 1999, janë përballuar nga përfaqësuesit e Kishës (“motrat”), duke qenë se vajza ka frekuentuar kopsht dhe shkollë të financuar nga Kisha.

²³ Përrjashtuar këtu “pasuria e llojit likuiditet në formë depozite në Credins Bank, në shumën 5.076.501 lekë”, pamjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme të së cilës rezultoi në shumën 3.922.935 lekë, 70.656 lekë më e ulët nga sa përlllogaritur nga Komisioni, si pasojë e korrigjimit të efektit financiar në analizën e Komisionit për vitin 2015, nga konvertimi i depozitave me monedhë në valutë. Shih arsyetimin e trupit gjykues në paragrafët nr. 78 e në vijim të këtij vendimi.

Subjekti pretendohet se ka dorëzuar në Komision foto të vajzës në kopsht dhe shkollë, si dhe dokumente që vërtetojnë frekuentimin e tyre nga vajza.

67. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe kontrolloi vendimin e Komisionit, konstatoi fillimisht se në faqen nr. 50 të këtij vendimi, në tabelën përmbledhëse e cila paraqitet si analizë përfundimtare pas sistemimeve dhe rillojaritjes së zërave financiarë nga Komisioni, shpenzimet e jetesës në Itali, për periudhën 1998 – 2004, janë përlllogaritur në shumën totale prej 8.788.345 lekësh. Përlllogaritja e këtij zëri në shumën e paraqitur në këtë tabelë përmbledhëse, nuk rezulton të ketë një pasqyrim të detajuar në mënyrë analitike, ku të identifikohen/kuptohen përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për çdo vit të periudhës së mësipërme.
68. Në këto kushte, trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, çmoi të nevojshme të ripërlllogarisë nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, shpenzimet e jetesës në Itali për periudhën e sipërcituar, mbi bazën e të dhënave të organit përgjegjës për statistikat në shtetin Italian²⁴. Nga kjo përlllogaritje, shpenzimet e jetesës në Itali, për familjen e subjektit të rivlerësimit me 3 anëtarë, për periudhën 1997 - shkurt 2004, rezultuan në shumën prej 9.324.996 lekësh²⁵. Trupi gjykues konstaton se, edhe nëse do pranohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mospërfshirjen në shpenzimet e përlllogaritura të shpenzimeve të jetesës për vajzën e mitur në vitin 1999²⁶, me pretendimin e mbulimit të tyre nga kisha, ndonëse i paprovuar me dokumentacion justifikues gjatë hetimit në Komision, apo edhe gjatë gjykimit në Kolegj, shpenzimet e jetesës do të përlllogariteshin në shumën totale prej 8.907.598 lekësh²⁷.
69. Në këto kushte, kur shpenzimet e jetesës të përlllogaritura në Kolegj rezultuan më të larta nga sa përlllogaritur nga Komisioni, në konsideratë edhe të faktit që pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi mbulimin e shpenzimeve të qirasë nga vëllai i bashkëshortit gjatë periudhës së emigrimit në Itali, mbetën në nivelin deklarativ, trupi gjykues çmoi të konfirmojë si të drejtë përlllogaritjen e kryer nga Komisioni, e cila rezultoi me një reduktim të këtij zëri shpenzimesh në shumën prej 536.651 lekësh, në favor të subjektit, referuar standardit të ndjekur nga Kolegji.
70. Subjekti pretendoi reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së saj K. H. në shumën 512 euro për udhëtimet e kryera në vitin 2010, në periudhat 24.08.2010 - 23.10.2010, 31.10.2010 - 19.12.2010 dhe 04.01.2011 - 09.04.2011, me arsyetimin se këto shpenzime janë të përfshira në shpenzimet e deklaruara për shkollim, në deklaratën periodike të vitit 2010 në shumën 5.200 GBP. Subjekti pretendoi se, në mbështetje të këtij pretendimi, ka depozituar si provë postën elektronike

²⁴ I.Stat Metadata Viewer (istat.it) – Soglia di povertà relativa.

²⁵ Përlllogaritur shpenzime jetese në Itali për familjen me tre anëtarë: (i) për periudhën 1997-1998, në shumën 1.114.717 lekë; (ii) në vitin 1999, në shumën 1.682.240.9 lekë; (iii) për vitin 2000, në shumën 1.271.672 lekë; (iv) për vitin 2001, në shumën 1.441.056 lekë; (v) për vitin 2002, në shumën 1.809.532 lekë; (vi) për vitin 2003, në shumën 1.865.861 lekë; (vii) për vitin 2004, në shumën 139.918 lekë. Në total, për të gjithë periudhën, në shumën 9.324.996 lekë.

²⁶ Shpenzimet që i atribuohen vajzës së mitur të subjektit të rivlerësimit në vitin 1999, rezultuan në shumën 417.398 lekë.

²⁷ Diferenca mes shpenzimeve të llogaritura për periudhën e sipërcituar për familjen me 3 anëtarë prej 9.324.996 lekësh dhe shumës që u takon shpenzimeve të jetesës për vajzën e subjektit në vitin 1999, prej 417.398 lekësh.

të dërguar nga shkolla ku, sipas saj, rezulton se shpenzimet e shkollimit dhe akomodimit për vajzën janë në shumën 3.868 GBP, dhe se në shumën e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010, janë të përfshira, përveç shpenzimeve të shkollimit dhe akomodimit, edhe shpenzimet e udhëtimit. Për rrjedhojë, sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit se *pretendimi i subjektit se diferenca prej 1.332 GBP është shpenzuar për udhëtimet, mbetet në nivel deklarativ, i pambështetur në dokumentacion provues ligjor*, është i pabazuar.

71. Subjekti i rivlerësimit ngriti të njëjtin pretendim për reduktim të shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së saj K. H. gjatë vitit 2011, në shumën e 720 eurove, të kryera në periudhat 26.04.2011 - 17.06.2011, 31.08.2011 - 22.10.2011, 30.10.2011 - 17.12.2011, si dhe në periudhën 08.01.2012 - 15.02.2012. Sipas subjektit, shpenzimet për këto udhëtime janë të përfshira në shumën prej 6.000 GBP, deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011, te shpenzimet për shkollimin e vajzës K. H. në Kolegjin {***}. Nga shuma prej 6.000 GBP, vetëm 5.167 GBP janë pagesë për shkollën, në të cilën përfshihen të gjitha shpenzimet gjatë shkollimit, akomodim dhe ushqim, dhe shuma e mbetur prej 833 GBP, janë shpenzuar për udhëtimet e kryera nga vajza në Britaninë e Madhe në shumën prej 720 eurosh. Shpenzimet për blerjen e biletës së udhëtimit të kryer në periudhën 08.01.2012 - 15.02.2012, janë kryer në vitin 2011 dhe, sipas subjektit, duhet të përfshihen në shumën e deklaruar si shpenzim i këtij viti. Konkluzioni i Komisionit se ky pretendim nuk qëndron pasi subjekti në deklaratën e vitit 2011, ka deklaruar shprehimisht: *Shpenzime për shkollimin e vajzës në kolegjin në Britaninë e Madhe, shuma 6.000 GBP*, sipas subjektit, është i pabazuar.
72. Në kuadër të shqyrtimit të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se në deklaratat periodike të viteve 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet për shkollimin e vajzës së saj në Mbretërinë e Bashkuar, respektivisht si vijon: “Pague për shkollimin e vajzës në kolegjin {***}, {***}, Britani e Madhe, shuma 5.200 GBP” dhe “Shpenzime për shkollimin e vajzës në kolegjin {***}, {***}, Britani e Madhe, shuma 6.000 pound (GBP)”.
73. Në shpjegimet e saj ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, lidhur me shpenzimet e udhëtimit të vajzës K. H. gjatë vitit 2010, të përfshira në analizën financiare, në vlerën prej 512 eurosh, ka prapësuar se: *shpenzimet për këto udhëtime janë të përfshira në shumën prej 5200 GBP, deklaruar në DPV-2010, te shpenzimet për shkollimin e vajzës K. H. në Kolegjin {***}. Konkretisht, nga shuma prej 5200 GBP, vetëm 3868 GBP janë pagesë e bërë nga ana jonë kolegjit, në të cilën përfshihen të gjitha shpenzimet për shkollim, akomodim dhe ushqim. Shuma e mbetur prej 1332 GBP, ose 215.065 lekë janë shpenzuar për udhëtimet e vajzës vajtje–ardhje (në datat e mësipërme) në Britaninë e Madhe, në shumën prej 512 eurosh, ose 70.815 lekësh. Pjesa tjetër janë shpenzime të ndryshme, pra nga ana jonë në shumën e deklaruar si shpenzime shkollimi, janë përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimit (biletat e avionit). Gjithashtu, theksoj se shpenzimet për biletën e datave 04.01.2011 - 09.04.2011, janë kryer në vitin 2010 dhe përfshihet në shpenzimet e deklaruara për shkollim (pra, në shumën 5200 GBP [...]).*
74. Po ashtu, në lidhje me shpenzimet e udhëtimit të vajzës K. H. gjatë vitit 2011, të përfshira në analizën financiare të Komisionit në vlerën totale prej 720 eurosh, subjekti ka prapësuar se: *shpenzimet për këto udhëtime janë të përfshira në shumën prej 6000 GBP, deklaruar në DPV 2011,*

*te shpenzimet për shkollimin e vajzës K. H. në Kolegjin {***}. Konkretisht, nga shuma prej 6.000 GBP, ku vetëm 5.167 GBP janë pagesë e bërë nga ana jonë kolegjit, në të cilën përfshihen të gjitha shpenzimet për shkollim, akomodim dhe ushqim. Shuma e mbetur prej 833 GBP, ose 138.211 lekë, janë shpenzuar për udhëtimet e vajzës vajtje-ardhje (në datat e mësipërme) në Britaninë e Madhe, në shumën prej 720 eurosh, ose 99.576 lekë. Gjithashtu, theksoj se shpenzimet për biletën e datave 08.01.2012 - 15.02.2012, është kryer në vitin 2011 dhe përfshihen në shumën e deklaruar si shpenzim i këtij viti [...].*

75. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegji, trupi gjykues konstaton se, nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike në shtator të vitit 2022, të vajzës së subjektit dhe strukturës përgjegjëse të shkollës lidhur me marrëdhëniet financiare²⁸, rezulton se personi i lidhur (vajza e subjektit të rivlerësimit) K. H. ka qenë studente pranë {***}, nga data 02.09.2010 - 02.06.2012. Sipas këtij komunikimi, rezulton se personi i lidhur ka përfituar bursë për çdo vit të shkollimit²⁹ dhe tarifa/kontributi i paguar nga prindërit e studentit është përcaktuar në shumat prej 3.868 GBP për periudhën 2010-2011, dhe në shumën prej 5.167 GBP për periudhën 2011-2012.
76. Trupi gjykues konstaton se nga detajimi i kostove/tarifave të paraqitura në pasqyrën e studentit bashkëlidhur komunikimit të mësipërm, rezulton që pagesat e kryera dhe bursa e ofruar përfshijnë, përveç shpenzimeve të shkollimit, edhe ato të akomodimit.
77. Nga verifikimet e kryera nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor lidhur me koston e udhëtimeve të kryera nga personi i lidhur në periudhat objekt kontrolli, rezultoi se shpenzimet për këto udhëtime të përlogaritura sipas metodologjisë të përcaktuar nga Kolegji, janë në shumat 540 euro³⁰ për vitin 2010 dhe 720³¹ euro për vitin 2011.
78. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues e gjeti të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në shpenzimet e deklaruara për shkollimin e vajzës së saj K. H., në deklaratat periodike të viteve 2010 dhe 2011, ka përfshirë, përveç pagesës së kryer shkollës për shkollimin dhe akomodimin e vajzës, edhe shpenzimet për udhëtimet e identifikuar sipas datave të sipërcituara, në vitet 2010, 2011 dhe 2012, shpenzime të cilat rezultuan të jenë më të vogla se diferenca mes tarifës së paguar shkollës për këto vite dhe shpenzimeve të deklaruara pranë ILDKPKI-së³². Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për reduktimin e zërit të shpenzimeve të udhëtimit të vajzës së saj K. H., për vitet 2010 dhe 2011, përkatësisht në shumat 512 euro dhe 720 eurove, u gjet i drejtë dhe u korrigjua në analizën e kryer nga Komisioni.

²⁸ S. L., Senior Credit Controller, Bursary: s***.l***@stclares.ac.uk.

²⁹ Përkatësisht shumën 25.000 GBP për periudhën 2010-2011, si dhe shumën 24.994 GBP për periudhën 2010-2011.

³⁰ Kosto bilete avioni vajtje-ardhje me linjë direkte brenda Evropës në shumën 180 euro x 3 udhëtime = 540 euro.

³¹ Kosto bilete avioni vajtje-ardhje me linjë direkte brenda Evropës në shumën 180 euro x 4 udhëtime = 720 euro.

³² Diferenca mes vlerës së deklaruar si shpenzim shkollimi në deklaratën periodike të vitit 2010 me vlerën e pagesës së kryer shkollës (5.200 GBP – 3.868 GBP = 1.332 GBP). Diferenca mes vlerës së deklaruar si shpenzim shkollimi në deklaratën periodike të vitit 2011 me vlerën e pagesës së kryer shkollës dhe vlera e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 me vlerën e referuar në postën elektronike të shkollës (6.000 GBP - 5.167 GBP = 833 GBP).

79. Subjektit i rivlerësimit, znj. Miranda Bushi, pretendoi se në analizën financiare për periudhën 2008 - 2015, duhet të përfshihet zëri “Të ardhura nga kursi i këmbimit” për depozitat në monedhën USD dhe GBP, për të cilat Komisioni në mënyrë të gabuar ka kryer konvertimin e tyre në monedhën lekë, duke i rezultuar për pasojë një rritje artificiale e likuiditetit në këto depozita, për shkak të rritjes së kursit të këmbimit, pa pasur një shtim apo pakësim real të tyre. Sipas saj, pretendoi se në praktikën e Kolegjit, ky zë është konsideruar si e ardhur për të saktësuar analizën financiare në kushtet kur likuiditeti nga viti në vit rritet/zvogëlohet për shkak të kursit të këmbimit, pa u zvogëluar apo rritur likuiditeti në monedhën e huaj.
80. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të fashikullit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit ka pasur 3 depozita. Më konkretisht, depozitën pranë Credins Bank në monedhën USD, krijuar në vitin 2008 dhe mbyllur në vitin 2016, depozitën në bankën BKT në monedhën GBP, krijuar në vitin 2011 dhe mbyllur në vitin 2013 dhe depozitën në bankën BKT në monedhën USD, krijuar në vitin 2011 dhe mbyllur në vitin 2016.
81. Në analizën financiare të kryer për periudhën e rivlerësimit, Komisioni ka përllogaritur në zërin “Diferencë likuiditeti”, për këto 3 depozita, likuiditetet nga monedha origjinale USD/GBP, duke i konvertuar ato në monedhën lek me kurs këmbimi të ndryshëm për çdo vit përkatës për periudhën 2008 - 2015, edhe pse këto likuiditete nuk janë shtuar gjatë viteve që kanë qëndruar në depozitë.
82. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi të nevojshme të verifikojë nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, efektin financiar të mënyrës së përllogaritjes dhe paraqitjes nga Komisioni në analizën financiare të tij, të depozitave të subjektit në monedhë të huaj, ndër vite, sipas praktikës së Kolegjit, duke konvertuar likuiditetet nga monedha e tyre në valutë (USD/euro/GBP) në monedhën lek, me kursin e vitit të krijimit të depozitës, duke mbartur në vitet në vijim të njëjtën balancë likuiditetesh, përveç në rast shtesash të likuiditetit në këto depozita, vlerat e të cilave janë konvertuar sipas kursit të këmbimit në vitin kur ka ndodhur shtesa.
83. Sipas verifikimit të kryer në përputhje me metodologjinë e mësipërme, rezultoi se në analizën financiare të Komisionit për periudhën 2009-2016, trupi gjykues konstatoi se depozitat e subjektit të rivlerësimit në monedhë të huaj të cilat janë konvertuar nga Komisioni në monedhën lek, për çdo vit sipas kursit të këmbimit të vitit përkatës mbi bazën e vlerës fillestare të depozitës në valutë edhe pse ajo nuk ka ndryshuar, rezultuan të kenë një efekt në rritje (artificiale) të vlerës së likuiditetit, përkatësisht në shumat 139.944 lekë në vitin 2009; 661.967 lekë në vitin 2010; 565.153 lekë në vitin 2011, 661.270 lekë në vitin 2012; 455.817 lekë në vitin 2013; 731.081 lekë në vitin 2014; 70.656 lekë në vitin 2015; 1.090 lekë në vitin 2016.
84. Në përfundim të kësaj analize, pasi e gjeti të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me efektet financiare në analizën e Komisionit nga konvertimi i depozitave me monedhë në valutë, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, korrigjoi këtë analizë sipas vlerave të përllogaritura më sipër, duke i përfshirë ato në një zë të veçantë, me përshkrim “Të ardhura nga kursi i këmbimit”.

85. Nga kontrolli i ushtruar në Kolegj ndaj analizës financiare të Komisionit për periudhën 1992 – 2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, edhe pse u vlerësuan të drejta pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ripërlllogaritjen e disa zërave të analizës financiare, si më sipër trajtuar, duke rezultuar pas korrigjimit me balancë pozitive për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, ndryshe nga sa përlllogaritur nga Komisioni, si dhe me pakësim të rezultatit negativ të analizës financiare të vitit 2015, në shumën (-) 118.288 lekë, trupi gjykues konstatoi se përsëri subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, në shumën (-) 27.395.735 lekë.
86. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte e në ligj dhe, për pasojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 666, datë 25.05.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Bushi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 11.11.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ
nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI
nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO
nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA
nënshkrimi